

20131643992

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12 dhe 13/13) pas nenit 77 shtohen 13 nene të reja: 77-a, 77-b, 77-v, 77-g, 77-d, 77-gj, 77-e, 77-zh, 77-z, 77-x, 77-i, 77-j dhe 77-k, si vijojnë:

"Neni 77-a

(1) Provimi për agjent jepet për kontroll të njohurisë së nevojshme profesionale për kryerjen e punëve të marketingut të fondeve pensionale.

(2) Provim për agjent mund të japë personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të ketë vendbanim në Republikën e Maqedonisë,
- të ketë të përfunduar së paku arsim të mesëm dhe
- me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës derisa zgjasin pasojat nga ndalimi.

Neni 77-b

(1) Provimi përbëhet prej dy pjesëve edhe atë:

- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve dhe
- pjesa e dytë (shembull praktik), me të cilën kontrollohet aftësia praktike e kandidatëve.

(2) Pjesa e parë e provimit nga paragrafi (1) i këtij neni jepet me shkrim në mënyrë elektronike, me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(3) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga:

- shembulli praktik dhe
- pyetje të cilave kandidati duhet t'u përgjigjet në bazë të analizës së shembullit praktik.

Neni 77-v

(1) Provimi jepet sipas programit në të cilin përmbahen materiali, rregullat dhe literatura.

(2) Programin për dhënie të provimit nga sfera përkatëse e miraton Agjencia.

Neni 77-g

(1) Bazat e pyetjeve për pjesën e parë të provimit dhe bazat e shembujve praktikë për pjesën e dytë të provimit nga neni 77-x të këtij ligji i përpilojnë profesorë nga sfera përkatëse dhe/ose persona profesionalë nga ndonjë nga sferat në vijim: sigurim pensional, procedurë administrative, treg i kapitalit dhe aktuari, të caktuar nga Agjencia.

(2) Pyetjet nga pjesa e parë e provimit dhe pyetjet dhe shembujt praktikë nga pjesa e dytë e provimit i verifikon Komisioni për verifikim të pyetjeve i përbërë prej tre përfaqësuesve të Agjencisë.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) të këtij neni, kryen edhe revizion dhe azhurnim të bazave të pyetjeve dhe bazave të shembujve praktikë nga neni 77-x të këtij ligji së paku një herë në vit.

(4) Gjatë revizionit Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, veçanërisht i ka parasysh ndryshimet e rregullave në të cilat bazohet pyetja përkatësisht shembulli praktik, numrin e kandidatëve të cilët i janë përgjigjur, suksesin në përgjigjen e tyre, si dhe kriteret tjera të cilat mund të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së bazave nga neni 77-x të këtij ligji.

(5) Në bazë të revizionit të kryer dhe azhurnimit të bazave të pyetjeve dhe bazave të shembujve praktikë, Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni vendos që pyetjet dhe shembujt praktikë të ndryshohen apo të mënjahohen plotësisht nga bazat nga neni 77-x të këtij ligji.

(6) Profesorët dhe personat nga paragrafi (1) të këtij neni dhe anëtarët e Komisionit nga paragrafi (2) të këtij neni kanë të drejtë në kompensim në para të cilin e cakton Agjencia.

(7) Shuma e kompensimit me para nga paragrafi (6) i këtij neni caktohet në bazë të numrit të pyetjeve të përpiluara dhe shembujve praktikë, si dhe ndërlikueshmërisë së materies.

(8) Shuma vjetore e kompensimit në para nga paragrafi (6) të këtij neni nuk e tejkalon nivelin e dy rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak, të publikuara nga Enti shtetëror për statistikë.

(9) Punët profesionale dhe administrative për nevojat e zbatimit të provimit i kryen Agjencia, ndërsa provimin teknikisht e zbaton personi juridik i regjistruar në Regjistrin qendror i zgjedhur nga Agjencia.

Neni 77-d

(1) Provimi për agjent zbatohet së paku dy herë në vit.

(2) Kërkesën për dhënie të provimit shoqëria pensionale e parashtron te Agjencia së bashku me dëshmi për plotësimin e kushteve për dhënie të provimit, të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Agjencia përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënie të provimit.

(4) Për kërkesat e miratuara për dhënie të provimit, Agjencia e cakton kohën dhe vendin për dhënie të provimit, ndërsa shoqëria pensionale njoftohet më së voni në afat prej tetë ditëve para dhënies së provimit.

(5) Kandidatit i mundësohet të fillojë ta japë provimin në terminin e parë të ardhshëm nga dita e kërkesës së miratuar për dhënie të provimit.

(6) Nëse kandidati nuk i plotëson kushtet për dhënie të provimit Agjencia miraton aktvendim për refuzim të kërkesës për dhënie të provimit, kundër të cilit mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Neni 77-gj

(1) Provimi për agjent jepet në lokal për dhënien e provimit, të pajisur veçanërisht për dhënien e provimit profesional me pajisje materiale-teknike dhe informatike, lidhje interneti dhe pajisje për incizimin e dhënies.

(2) Publiku informohet për datën dhe kohën e dhënies së provimit së paku tri ditë para mbajtjes së provimit.

(3) Dhënia e provimit incizohet dhe drejtpërdrejt emitohet në ueb faqen e Agjencisë, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi i provimit të plotë vendoset në ueb faqen e Agjencisë.

(4) Kriteret për kushtet hapësinore dhe pajisjen materiale-teknike dhe informatike të lokaleve për dhënien e provimit profesional më afërsisht i përcakton Agjencia.

(5) Në lokalin për dhënie të provimit, gjatë kohës së dhënies së provimit janë të pranishëm tre përfaqësues të Agjencisë prej të cilëve një është informatikan.

Neni 77-e

(1) Para fillimit të dhënies së provimit, përfaqësuesi nga Agjencia e përcakton identitetin e kandidatit me shikim të letërnjoftimit.

(2) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë të provimit, nuk i lejohet shfrytëzimi i ligjeve, ligjeve me koment dhe sqarim, telefonit mobil, aparateve kompjuterike portative dhe mjeteve tjera teknike dhe informatike, lëndëve të përgatitura paraprakisht dhe ngjashëm.

(3) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së dytë të provimit, i lejohet shfrytëzimi vetëm i ligjeve (pa komente dhe sqarime), që në version elektronik gjenden në kompjuterin në të cilin kandidati e jep provimin.

(4) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë ose persona tjerë përveç me informatikanët nga neni 77-gj paragrafi (5) të këtij ligji, nëse ka problem teknik me kompjuterin.

(5) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanoen për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanoen në këtë afat, provimi ndërpritet vetëm për atë kandidat dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(6) Nëse ka probleme me më shumë se pesë kompjuterë dhe ato nuk mënjanoen në afat prej pesë minutash provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që e japin provimin dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit .

(7) Nëse kandidati gjatë dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit , vepron në kundërshtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, nuk do t'i lejohet dhënia e mëtejme e provimit në atë termin të caktuar.

(8) Në rastet nga paragrafi (7) i këtij neni, konsiderohet se kandidati nuk e ka dhënë provimin dhe kjo konstatohet në procesverbalin për dhënien e provimit.

(9) Përfaqësuesi i autorizuar nga neni 77-gj paragrafi (5) i këtij ligji, gjatë kohës së dhënies së provimit nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të kandidatit që e jep provimin, përveç në rast të mënjanimin të problemit teknik, kur nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë minuta.

Neni 77-zh

(1) Nëse gjatë dhënies së provimit krijohen shkaqe të arsyeshme për të cilat kandidati nuk mund ta vazhdojë dhënien e provimit profesional (sëmundje, pushim i lindjes dhe ngjashëm), do të ndërpritet provimi për një kohë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë muaj.

(2) Aktvendim për vazhdim të provimit miraton kryetari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë me kërkesë të shoqërisë pensionale. Kërkesa parashtrohet në afat prej tetë ditëve nga ndërprerja e shkaqeve për prolongim të provimit, por më së voni në afat prej gjashtë muajsh.

(3) Nëse shoqëria pensionale nuk parashtron kërkesë për vazhdim të dhënies së provimit në afatin e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni do të konsiderohet se provimi nuk është dhënë.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(5) Në vazhdimin e provimit, kandidati nuk e jep atë pjesë të provimit të cilën paraprakisht tanimë e ka dhënë.

Neni 77-z

(1) Provimi profesional fillon me dhënien e pjesës së parë (pjesës teorike), e pastaj të pjesës së dytë (shembullit praktik).

(2) Pjesa e dytë jepet në afat prej së paku pesë ditësh pas dhënies së suksesshme të pjesës së parë.

(3) Agjencia më afërsisht e përcakton mënyrën e ndarjes së pikëve në pjesën e parë dhe të dytë të provimit.

(4) Pjesa e parë e provimit jepet për çdo sferë përkatëse dhe përmban së paku 50 pyetje me pesë opsione për rrethim prej të cilave njëra është e saktë, dy janë të ngjashme, njëra është e pasaktë në masë të vogël (në të humben numër i vogël pikësh) dhe njëra është e pasaktë në masë të madhe (në të humben numër i madh pikësh).

(5) Kusht për dhënien e pjesës së dytë të provimit është kandidati ta japë pjesën e parë të provimit.

(6) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e parë të provimit në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni, do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

(7) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga shembulli praktik.

(8) Pyetjet të cilat janë pjesë përbërëse e shembullit praktik janë nga sfera përkatëse dhe kanë pesë opsione të mundshme përgjigjesh prej të cilave njëra është e saktë, tri janë të ngjashme dhe dy janë të ndryshme.

(9) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e dytë të provimit, do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

Neni 77-x

(1) Dhënia e pjesës së parë të provimit profesional bëhet me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(2) Pyetjet e testit varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

(3) Dhënia e pjesës së dytë të provimit profesional kryhet me studim të shembullit praktik dhe përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve që dalin nga shembulli praktik, në formë të zgjidhjes softuerike elektronike (në tekstin e mëtutjeshëm: shembull praktik elektronik).

(4) Pyetjet nga shembulli praktik varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në shembullin praktik.

(5) Pyetjet e përmbajtura në testet për dhënien e pjesës së parë të provimit dhe përgjigjet e tyre, si dhe shembulli praktik dhe pyetjet që dalin nga shembujt praktikë dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit.

(6) Sistemi elektronik nga paragrafi (5) i këtij neni përmban edhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 100 pyetje për çdo sferë, si dhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 30 shembujve praktikë për çdo sferë, për nevojat e pjesës së dytë të provimit.

(7) Në sistemin elektronik përmbahet edhe udhëzim për rregullat dhe literaturën në të cilat përmbahen përgjigjet e pyetjeve nga pjesa e parë e provimit dhe rregullat për pjesën e dytë të provimit.

(8) Rezultatet nga dhënia e pjesës së parë dhe të dytë të provimit, kandidati i ka të kapshme në kompjuterin në të cilin e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

Neni 77-i

(1) Në ditën e dhënies së pjesës së parë, përkatësisht pjesës së dytë të provimit, përfaqësuesi i Agjencisë kandidatit i jep kod të qasjes, përkatësisht fjalëkalim me të cilin i lejohet qasje në sistemin elektronik nga neni 77-x të këtij ligji.

(2) Pas lejimit të qasjes, kandidati merr test elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembull praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit, të gjeneruara në mënyrë kompjuterike, përmbajtjen e të cilave sipas zgjedhjes së rastësishme e cakton softueri i sistemit elektronik nga neni 77-x paragrafi (5) të këtij ligji nga bazat e nenit 77-x paragrafi (6) të këtij ligji.

(3) Pjesa e parë dhe e dytë e provimit, përmbajnë udhëzim për mënyrën e zgjidhjes së provimit, për të cilin përfaqësuesi i Agjencisë jep sqarim, para se të fillojë dhënia e provimit.

(4) Sistemi elektronik për dhënien e provimit nuk mund të lejojë ekzistimin e përmbajtjes identike të testit elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembullit praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit në një termin për më shumë se një kandidat.

(5) Në rast të pengimit të realizimit të pjesës së parë ose të dytë të provimit për shkaqe që shpijnë në pamundësi teknike të funksionimit të sistemit elektronik nga neni 77-x të këtij ligji, dhënia e provimit ndërpritet.

(6) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni mënjanohen në afat prej 60 minutash nga ndërprerja e provimit, ai vazhdohet menjëherë pas mënjanimit të tyre.

(7) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mënjanohen në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni, provimi ricaktohet për termin tjetër.

(8) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga pjesa e parë e testit për dhënien e provimit, është 120 minuta.

(9) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve të testit ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

(10) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga secili prej shembullit praktik të pjesës së dytë, është 120 minuta.

Neni 77-j

(1) Kandidatëve që e kanë dhënë provimin për agjentë u lëshohet certifikatë në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të provimit.

(2) Formën dhe përmbajtjen e certifikatës nga paragrafi 1 të këtij neni, e përcakton Agjencia.

(3) Me kërkesë të kandidatit Agjencia e informon për gabimet e bëra në testin për dhënie të provimit profesional, me mundësi për shikim të drejtpërdrejtë në test.

(4) Testet dhe shembujt praktikë shfrytëzohen dhe i jepen kandidatit vetëm gjatë kohës së dhënies së provimit profesional.

(5) Materialet nga provimet e mbajtura, veçanërisht versionet në letër nga testet dhe shembujt praktikë për dhënien e provimit profesional dhe specimenet për kontroll të saktësisë së përgjigjeve të testit dhe shembullit praktik, si dhe incizimet nga provimet e mbajtura ruhen në Agjenci.

(6) Komisioni nga neni 77-g paragrafi (2) të këtij ligji, kryen revizion të provimeve të mbajtura.

(7) Komisioni nga paragrafi (6) i këtij neni, mban mbledhje së paku një herë në vit dhe kryen revizion të mënyrës së zbatimit të së paku dy provimeve të mbajtura në vitin rrjedhës.

(8) Komisioni nga paragrafi (6) i këtij neni, ka të drejtë të kryejë revizion edhe të mënyrës së realizimit të provimeve të mbajtura në dy vitet e fundit deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes së komisionit, por jo më herët nga dita e zbatimit të këtij ligji.

(9) Nëse Komisioni nga paragrafi (6) të këtij neni konstaton parregullsi në realizimin e provimit nga individë sipas nenit 77-e paragrafi (5) të këtij ligji, propozon heqjen e certifikatës nga paragrafi (1) i këtij neni.

(10) Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë miraton aktvendim për heqje të certifikatës në bazë të propozimit të Komisionit nga paragrafi (6) të këtij neni në afat prej tri ditëve nga pranimi i propozimit.

(11) Kundër aktvendimit nga paragrafi (10) të këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditëve nga pranimi i aktvendimit.

Neni 77-k

(1) Shpenzimet për dhënie të provimit i bart shoqëria pensionale.

(2) Shpenzimet nga paragrafi (1) të këtij neni i cakton Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë në bazë të shpenzimeve të bëra reale për dhënien e provimit, të domosdoshme për realizimin e pjesës së parë dhe të dytë të provimit, përgatitjen e bazave të pyetjeve, realizimin e testit elektronik, përgatitjen e materialeve dhe thirrjeve dhe përgatitjen e certifikatave.

(3) Shpenzimet për dhënien e provimit paguhen në llogarinë e të hyrave personale të Agjencisë.

(4) Nëse shpenzimet nuk janë paguar në llogari përkatëse të Agjencisë, më së voni 15 ditë para ditës së caktuar për zbatim të provimit, kandidatit nuk i lejohet dhënia e provimit.

(5) Nëse kandidati në afat prej një viti nga dita e pagimit të mjeteve nuk e jep provimin, mjetet e paguara i kthehen në pajtim me ligjin.”

Neni 2

Në nenin 134 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 20 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, nëse:

1) nuk miraton Kodeks për menaxhim të mirë korporativ dhe nuk punon në pajtim me nenin 4 paragrafi (3) të këtij ligji;

2) nuk vendos mekanizma efikas kontrollues dhe nuk vendos procedura dhe nuk cakton persona në pajtim me nenin 18-b të këtij ligji;

3) nuk themelon njësi organizative në pajtim me nenin 21-a paragrafi (1) të këtij ligji;

4) nuk i respekton detyrimet nga neni 21-b paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij ligji;

5) nuk vendos aktivitete për menaxhim me rreziqe, nuk emëron person përgjegjës për menaxhim me rreziqe dhe nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 21-v paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij ligji;

6) nuk i plotëson detyrimet nga neni 21-g të këtij ligji dhe aktet e përcaktuara nga Agjencia;

7) nuk emëron revizor të autorizuar të jashtëm me referenca të mira dhe nuk shpall ekstrakt nga raporti i reviduar financiar me mendim të revizorit të autorizuar në pajtim me nenin 22 të këtij ligji;

8) vepron në kundërshtim me nenin 22-b të këtij ligji dhe

9) nuk ka dokument për strategji investuese me përmbajtje në pajtim me nenin 112-a paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe aktet e përcaktuara nga Agjencia.”

Neni 3

Në nenin 136-g paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në Agjenci nëse:

1) pranon funksion ose punësim ose fiton aksione në kundërshtim me nenin 51 paragrafi (7) të këtij ligji;

2) nuk miraton aktvendim në afatin e përcaktuar me nenin 77-j paragrafi (10) të këtij ligji dhe

3) vepron në kundërshtim me nenin 77-e paragrafi (9) të këtij ligji.”

Neni 4

Pas nenit 136-e shtohet nen i ri 136-zh si vijon:

"Neni 136-zh

Gjobë në shumë prej 5 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili e zbaton provimin në kundërshtim me nenin 77-g paragrafi (9) i këtij ligji.”

Neni 5

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj miratohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 6

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 7

Procedurat e filluara për dhënie të provimit të agjentëve deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të rregullave sipas të cilave kanë filluar.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa nenet 1 dhe 4 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.